



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister*

Datë: 5/12/2023

Ref: 609/2023

E nderuara familja Kabashi,

Me pikëllim të thellë e mora lajmin e ndarjes nga jeta të artistit të kombit, Mirush Kabashi. Përmes roleve, punës e përkushtimit të tij ndër vite, ai na dha gjithçka nga shpirti i tij artistik.

Si shumë të tjerë, Mirush Kabashin do ta kujtoj gjithmonë për interpretimet e tij aq të fuqishme dhe mjeshtërore të poezisë shqipe në skenë, plot pasion e përkushtim, të cilat të përfshinin emocionalisht e ku ishte e pamundur të mos ndjeje rrëqethje e trazim emocional.

Aktori i mbi 100 roleve në teatër dhe filma, me punën dhe veprat e tij, do mbetet përjetësisht një thesar në kulturën e kombit shqiptar. Përveç artistit, ato janë gjurmët e një aktivisti të shumë kauzave sociale e një zëri të fortë të çështjes kombëtare.

Më lejoni që nëpërmjet këtij telegrami, t'iu përcjell ngushëllimet e mia më të sinqerta, të Qeverisë dhe mbarë popullit të Republikës së Kosovës.

Ndarja nga jeta e Mirushit është humbje e madhe për të gjithë shqiptarët. Shpresoj që mes veprave e kujtimeve për të, ta gjeni forcën për ta përballuar këtë dhimbje, në të cilën nuk jeni vetëm.

Me nderime,

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës